



Njerëzit nuk janë bërë ta strukin zemrën nën mburojë

Mësymja e së tashmes ndaj
kohës së ngelur

**ALEXANDER KLUGE:
NJË RETROSPEKTIVË**

6.2. - 8.2.25

kino armata
Brigada e Kosovës
10 000 Prishtina
Kosovo

hani i dy robertëve
Hajdar Dushi 62
10 000 Prishtina
Kosovo

info:

mail@stralli.org

Instagram: Stralli_org

Facebook: Stralli

financuar nga / financed by

GOETHE-ZENTRUM
KOOPERATIONSPARTNER



partnerë / partners

ARMATA



Deutscher Akademischer Austauschdienst
German Academic Exchange Service

Hani i 2 Robertëve

organizuar nga / organized by

STRALLI

THURSDAY / E ENJTE, 6.2.25

17:00

kino armata
Hapja e Mësymja e së tashmes ndaj kohës së ngelur
ALEXANDER KLUGE: NJË RETROSPEKTIVË
Fjala përshëndetëse e Ambasadës Gjermane – Prishtinë
Fjala përshëndetëse e Goethe-Zentrum – Prishtinë
Fjala përshëndetëse nga drejtuesit e „Alexander Kluge: një retrospektivë"

17:15

kino armata
Sferat publike dhe kontra-publike pas krizave
Prof. Dr. Rainer Stollmann (Universiteti i Bremenit) së bashku me
Alexander Kluge (online)
Ligjërata dhe bashkëbisedim (në gjuhën angleze) moderon: Alexander Vojvoda

18:00

kino armata
Shfaqja e filmave

Artisti dhe vajza e tij
2007, 1 min
Film 1-minutësh, Gjermani, OV me titra anglisht
Lamtumirë ngjarjeve të djeshme
Abschied von Gestern
1966, 88 min
Feature Film, RFGJ, OV me titra anglisht

afterparty: hani i dy robertëve

FRIDAY / E PREMTE, 7.2.25

10:00

hani i dy robertëve

Rreziku i të mbeturit të butë - Kritika feministe e Alexander Kluge mbi blindimin

Daniel Göntzer, BA MA (Universiteti i Vjenës)

Workshop (në gjuhën angleze)

13:00

kino armata
Shfaqja e filmave

Mësymja e së tashmes ndaj kohës së ngelur
Der Angriff der Gegenwart auf die übrige Zeit
1985, 106 min
Feature Film, RFGJ, OV me titra anglisht

Filmat një-minutësh: Sausages from Halberstadt
Marrëveshjet e paqes janë aq të pabesa
Ai se dëgjon fare!
Sam remembers Papa Kong
Trekëndëshi vdekjeprurës
Banorët e Shangait buzë lumit Souzhou
Gruaja në fushëbetejë
Stuhi mbi Egjipt
Lajmi i hidhur
Çdo herë pas përmbysjes
Shikoni ju lutem drejt në kamerë

17:00

kino armata
Shfaqja e filmave
Artistët nën çatinë e cirkut: të përhumbur
Artisten in der Zirkuskuppel: Ratlos
1968, 104 min
Feature Film, RFGJ, OV me titra anglisht

18:30

kino armata

"Making an effort alone is of no use".
Mbi "Artistët nën çatinë e cirkut: të përhumbur" dhe "Patriotja"

Blerta Hoçia
Ligjërata (në gjuhën angleze) moderon: Verena Walzl

Shfaqja e filmave
Patriotja
Die Patriotin
1979, 121 min
Feature Film, RFGJ, OV me titra anglisht

afterparty: hani i dy robertëve

SATURDAY / E SHTUNË, 8.2.25

10:00

hani i dy robertëve

"Kopshtendërtoj, rrënojave u besoj."
Alexander Kluge në kontekst

Prof. Dr. Rainer Stollmann (Universiteti i Bremenit)

Workshop (në gjuhën angleze)

13:00

kino armata
Shfaqja e filmave

Lajme të përziera
Vermischte Nachrichten
1986, 97 min
Feature Film, RFGJ, OV me titra anglisht
Dashuri e verbër. Bisedë me Jean-Luc Godard
Blinde Liebe: Gespräch mit Jean-Luc Godard
2001, 24 min
dctp, emision televiziv, Gjermani, OV me titra anglisht

"Rreziku shfaqet në pikën më të ndjeshme". Ish-Ambasadori i SHBA-së Richard C. Holbrooke, mbi skenarët e konflikteve në botë
2004, 16 min
dctp, emision televiziv, Gjermani, OV me titra shqip

"Udhëtimet nëpër rajonet e krizave në botë." Raport nga redaktorja e Spiegel në teren Dr. Carolin Emcke 'nga luftërat'
2005, 25 min
dctp, emision televiziv, Gjermani, OV me titra shqip

17:00

kino armata
The war is back! "Abetarja e luftës 2023" (Kriegsfibel) e Alexander Kluges

Prof. Dr. Rainer Stollmann (Universiteti i Bremenit)
Daniel Göntzer, BA MA (Universiteti i Vjenës)
Alban Beqiraj (Përkthyes i "Abetarja e luftës 2023")
Panel (në gjuhën angleze) moderon: Dr. Blertë Ismajli (Universiteti i Prishtinës)

Shfaqja e filmave
Lufta dhe paqja
Krieg und Frieden
1982, 118 min
Dokumentar / film eseistik, 1982, 123 min, OV me titra shqip

"Ç'është lufta? Oskar Negt mbi konstantet dhe ndryshimet e luftës në shekullin 21" Was ist Krieg? Oskar Negt über Konstanten und Veränderungen des Kriegs im 21. Jahrhundert
2002, 24 min
dctp, emision televiziv, Gjermani, OV me titra shqip

afterparty: hani i dy robertëve

Alexander Kluge Retrospektivë
Mësymja e së tashmes ndaj kohës së ngelur

"Mësymja e së tashmes ndaj kohës së ngelur" është retrospektiva e parë e veprës së Alexander Kluges në Kosovë. Ajo e fton publikun tonë të njihet me krijimtarinë kryesore të kineastit, filozofit, producentit televiziv, autorit dhe intelektualit më me ndikim në Gjermani. Në bashkëpunim me Goethe-Zentrum në Prishtinë dhe Kino Armata, kjo retrospektivë ofron një perspektivë unike ku mund të shtjellohen tema, si ajo e kujtesës, identitetit kolektiv, narrativat mbi ballafaqimin me të kaluarën, si dhe aspekte tjera transformuese që e karakterizojnë këtë lloj kinemasë. Ithtari i Shkollës së Frankfurtit, Kluge prej kohësh cilësohet figurë qendrore në kinemanë, letërsinë dhe teorinë e medias gjermane. Si pionier i valës Filmi i Ri Gjerman, filmat e tij sfidojnë strukturat tradicionale narrative, duke ndërthurur trilerin, dokumentarin dhe filmin eksperimental. Trajtimet inovative të Kluges lëvrojnë tema mbi historinë, sferën publike dhe kontra-publike, duke shtjelluar e vendosur paralele përvojash kolektive dhe personale. Veprat e tij karakterizohen nga një mendësi interdisiplinore që mjugullojnë kufijtë mes zhanreve dhe formave e mjeteve të tjera të shprehshmërisë kulturore. Kluge përdor elemente filmike për të ndriçuar marrëdhëniet komplekse në shoqëri dhe të përvojave individuale. Ai shkon përtej përfaqësimeve të thjeshta dhe sfidon shikuesin të reflektojë në mënyrë kritike mbi realitetin.

Në qendër të retrospektives është edhe koncepti i autorit mbi "kontra-publiket", që i shtjellon kryesisht në filma, por edhe në platformën televizive, të ashtuquajturën DCTP (Development Company for Television Program), platformë kjo e pavarur mbi perspektivat alternative televizive dhe karakterin kritik. DCTP u angazhua si kundër-përgjigje ndaj monopolit të diskursit publik, duke i ofruar hapësirë zërave të rinj krijues si dhe formave narrative të marginalizuara në përgjithësi. Një peizazh i tillë mediatik ka evoluar edhe në pasluftën e Kosovës, prandaj njohja e Kluges mbi kundër-publiket ofron njohuri të rëndësishme për nxitjen e formave pluraliste dhe alternative në komunikim.

Retrospektiva paraqet një përzgjedhje të kujdesshme të filmave. Aty përfshihen Lamtumirë ngjarjeve të djeshme ("Abschied von gestern", 1966), një vepër e rëndësishme që kritikon normat shoqërore dhe merr për bazë temën e tjetërsimit në Gjermaninë e pasluftës, pastaj Artistët nën çatinë e cirkut: të përhumbur ("Die Artisten in der Zirkuskuppel: Ratlos", 1968), që u shpërblye me Luanin e Artë në Festivalin e Filmit të Venedikut për qasjen e thellë dhe rolin e artit në shoqëri.

Krahas projektimit të filmave, retrospektiva përfshin edhe ligjërata, workshope dhe panele diskutimi. Studiues, artistë dhe krijues nga fusha të ndryshme të kulturës, do të shpalosin pikëpamjet dhe përvojat e tyre lidhur me krijimtarinë e Kluges në kontekstin e përpjekjeve të vazhdueshme të Kosovës për të formësuar ligjërimin publik dhe narrativën kulturore. Nata e hapjes do të përmbajë ligjëratën qendrore të Prof. Dr. Rainer Stollmann, me temën "Sferat publike dhe kontra-publike pas krizave", i cili në kuadër të teorisë së Kluges do të inkorporojë disa aspekte që ndërlidhen me ngjarje të caktuara dhe çështjet e Kosovës. Në diskutim përmes platformës zoom/online do të përfshihet edhe z. Alexander Kluge.

Meqë Kosova shënon 25 vjetorin e përfundimit të luftës, kjo retrospektivë shërben si urë lidhëse në mes të kaluarës dhe së tashmes së saj, duke ftuar audiencën të rimendojë mundësitë mbi diskursin publik, kreativitetin kulturor dhe këmbimin e njohjes së ndërsjellë. Përmes trashëgimisë vizionare të Kluges, audiencia vendore do të përfshihet në një komunikim me artin, kulturën e medias, dhe ballafaqimin me sfidat e historisë.

Retrospektiva realizohet si bashkëpunim i organizatës Stralli, Goethe Zentrum Prishtina, Kino Armata dhe DAAD Kosovo

kino armata
Brigada e Kosovës
10 000 Prishtina
Kosovo

hani i dy robertëve
Hajdar Dushi 62
10 000 Prishtina
Kosovo

info:

mail@stralli.org

Instagram: Stralli_org

Facebook: Stralli

Feature Films

Abschied von Gestern (“Lamtumirë ngjarjeve të djeshme “) RFGJ	kino armata
Feature Film, 1966, 88 min	E ENJTE, 6.2.25, 18:00
“Fajin e kemi vetë për gjithçka, sikur të dinim kaq, parajsë do ishte kjo botë.”	
Lamtumirë ngjarjeve të djeshme ("Abschied von Gestern ", 1966) konsiderohet gurtthemeli i kinematografisë së Filmit të Ri Gjerman, dhe është njëri prej filmave debutues që bëri bujë, dhe që i solli famën autori. Ky film poetik dhe me peshë politike shpalosë rrëfimin e Anita G. (Alexandra Kluge, motra e autorit), një vajze të re nga Gjermania Lindore, e cila zhytet në përditshmërinë e Gjermanisë Perëndimore, në përpjekje për t'u arratisur nga e kaluara. Përmes stilit dhe mënyrës së rrëfimit të fragmentuar, Kluge kritikon shoqërinë gjermane të pasluftës, duke shtjelluar temat, si ajo e tjetërsimit, burokracisë dhe identitetit – të ndërthura me elemente të reja shprehëse trileri dhe ato të filmit dokumentar. Filmi u shpërblye me Luanin e Argjendtë në Festivalin e Filmit në Venedik (1966).	

Die Artisten in der Zirkuskuppel: Ratlos („Artistët nën çatinë e cirkut: të përhumbur") RFGJ	E PREMTE, 7.2.25, 18:00
Feature Film, 1968, 104 min	
"Pas luftërave botërore, tash u lodha së stërvituri kafshë sa për spektakël."	
Artistët nën çatinë e cirkut: të përhumbur (1968) rrëfen përpjekjet e Leni Peikkert (Hannelore Hoger), një sipërmarrëse që synon ta rrisë cilësinë artistike në një hapësirë krejt të re cirku. Si prioritet ka lojën e natyrshme të kafshëve, si alternativë që të mund ta reformonte edhe cirkun. Por, këto ideale e çojnë kompaninë në falimentim. Rrëfimet eksperimentale të Kluges, të kombinuara me elemente të dokumentarit dhe fiksionit, eksplorojnë tema si: dështimi artistik, kufizimet shoqërore dhe lufta për inovacion brenda botës konformiste. Filmi u shpërblye me Luanin e Artë në Festivalin e Filmit të Venedikut (1968).	

Die Patriotin (“Patriotja”) RFGJ	E PREMTE, 7.2.25, 19:30
Feature Film, 1979, 121 min	
“Gabi Teichert është gati përherë konfuze. Sepse gjithçka është kontekst.”	
Në filmin Patriotja (“Die Patriotin”, 1979) Gabi Teichert (Hannelore Hoger) i hyn aventurës së gjurmimit të rrënjëve të historisë gjermane. Si arsimtare e historisë, Gabi Teichert është ihtarë e edukimit dhe përparimit. Ajo hulumton mbi tensionet ndërmjet autonomisë individuale, inercisë shoqërore dhe angazhimit për të arritur drejt një vendi dhe politike të bazuar në iluminizëm (emancipim) dhe llogaridhënie. Me Patriotja, Alexander Kluge kritikon marrëdhëniet e shtetit gjerman mes historisë së vet, duke parë si të domosdoshme aspektin kritik, mirëkuptimin dhe kërkimin për të parandaluar përsëritjen e gabimeve të së shkuarës.	
Krieg und Frieden (“Lufta dhe paqja") RFGJ	E SHTUNË, 8.2.25, 19:30
Dokumentar / film eseistik, 1982, 123 min	
"Asgjë nuk të shkurajon aq sa mos jesh në gjendje ta kuptosh lojën prej së cilës varet jeta jote."	
"Herë pas here, lufta ëndërron për idenë e saj absolute."	
Më 1945-ën, nëse lufta në Evropë do të përfundonte në gusht e jo në maj, bomba atomike fare mirë mund të ishte lëshuar në Berlin në vend të Hiroshimës. Rrethana të ngjashme mund të përsëriteshin gjatë krizës së armatimit raketor nga Lufta e Ftohtë e viteve 1980, ku Gjermania rrezikohet nga shkatërrimi i shpërthimeve nukleare. Ky film trajton iluzionin se rreziku ndaj luftës konsiderohet si kapitull i përmbyllur, por ja që ato na kujtojnë se konfliktet e pazgjidhura historike mund të rikthehen në çdo çast. Alexander Kluge bën apel për ndërgjegjësim kritik, veprim kolektiv dhe solidaritet përballë padrejtësive globale dhe pasojave të krizave politike.	

Der Angriff der Gegenwart auf die Übrige Zeit („Mësymja e së tashmes ndaj kohës së ngelur”) RFGJ	E PREMTE, 7.2.25, 13:00
Feature Film, 1985, 97 min	
"Në kokë ai kishte lloj-lloj imazhesh."	
A mund ta kategorizojmë shekullin 20-të në të ashtuquajturin plan katërvjeçar? Qysh ndërthuren tregu i mbeturinave recikluese me kulturën? Çfarë ndikimi kanë realisht masmediat? Një mjeke e re ka ndjesinë se është pothuajse e padobishme. Një familje rri përballë një kompjuteri, ngjashëm po sikur mblidhej përreth vatrës. Dikush ka ngut. Njerëzit ndajnë rrugët mes veti. Me filmin Mësymja e së tashmes ndaj kohës së ngelur, Alexander Kluge eksploron marrëdhënien ndërmjet kohës, modernitetit dhe ekzistencës njerëzore. Filmi kritikon mënyrën sesi shoqëria bashkëkohore, e shtyrë nga teknologjia, media dhe presionet ekonomike, çrregullojnë ritmet dhe vlerat tradicionale, që e shpien atë drejt një lloj perceptimi të fragmentuar të jetësor.	

Vermischte Nachrichten (“Lajme të përziera”) RFGJ	E SHTUNË, 8.2.25, 13:00
Feature Film, 1986, 101 min	
"Në brigjet e Nilit, panoramat na janë shpërndar. "	
Filmi është frymëzuar nga rubrika "lajme të përziera" të gazetave tradicionale, ku mbikëqyrja editoriale ishte fare e lirë. Rubrika të tilla shpeshherë përmbanin një larmishmëri të çuditshme lajmesh, që pasqyronin pamje unike e të fragmentuar të realitetit, herë shpërfillëse - anashkaluese sa edhe të papërpunuara mirë. Filmi shpalosë pamje të ngjarjeve të pafiltruara – një lloj kaleidoskopi të absurditeteve dhe tragjedi ve jetësore – duke trajtuar njëkohësisht edhe tema si ajo e dashurisë, e vdekjes dhe mbijetesës mbi një botë moderne krejtësisht të shkëputur.	

dctp - Alexander Kluge's Television Project kryesisht TË SHTUNËN, 8.2.25	kino armata
dctp (Development Company for Television Program), u themelua nga Kluge më 1987, është platforma me emisione televizive kulturore që drejtohet nga vetë autorët. Kjo platformë është një përgjigje ndaj dominimit të transmetimeve komerciale, që synon të ofrojë një alternativë të larmishme krahas rrjeteve transmetuese televizive private në Gjermani. Projekti dctp ndërthur artin, kulturën, historinë dhe filozofinë me stil eksperimental rrëfimi. Këto programe përfshijnë intervista, imazhe arkivore dhe komentime me karakter reflektues që sfidojnë formate tradicionale televizive, duke nxjerrë në pah një "sferë kontra-publike", narrativa alternative dhe duke ftuar në emisione zëra të papërfaqësuar. dctp kryesisht i fragmenton rrëfimet dhe eksploron temat si lufta, koha dhe emocionet njerëzore, shpesh të ndërthurura me histori personale dhe ngjarje historike. Përtej televizionit, dctp ndikon në teorinë e medias dhe ligjërimin publik, duke mishëruar vizionin e Kluge për median si një mjet për edukim dhe emancipim. Si ndëthurje e artit dhe mendimit kritik, dctp mbetet një forcë pioniere e medias kulturore.	
Blinde Liebe. Gespräch mit Jean-Luc Godard („Dashuri e verbër. Bisedë me Jean-Luc Godard ") Gjermani	
dctp, emision televiziv, 2001, 24 min	
Dashuri e verbër. Bisedë me Jean-Luc Godard në thelb është një dialog magjepsës mes dy kineastëve me ndikim botëror. Biseda e tyre shtrton pyetje komplekse mbi natyrën e kinemasë, të rrëfimit dhe marrëdhënies ndërmjet imazhit dhe realitetit. Kjo bisedë zhytet edhe në tema filozofike e politike, ku interesimi i përbashkët i autorëve synon t'i sfidojë format tradicionale të kinematografisë, si dhe kufijtë e artit të filmit.	
Një planet tjetër: Nina Wetzel mbi jetesën në kampin kosovar (2000, 16 min) "Rreziku shfaqet në pikën më të ndjeshme". Ish-Ambasadori i SHBA-së Richard C. Holbrooke, mbi skenarët e konflikteve në botë (2004, 15 min) “Ç’është lufta? Oskar Negt mbi konstantet dhe ndryshimet e luftës në shekullin 21” (2002, 24 min) “Udhëtimet nëpër rajonet e krizave në botë." Raport nga redaktorja e Spiegel në teren Dr. Carolin Emcke "nga luftërat" (2005, 25 min)	

Filmat një minutësh

Filmat një-minutësh: janë copëza të shkurtra kinematografike që përfaqësojnë qasjen e veçantë të krijimtarisë vizuale të autorit. Ato zgjasin fare shkurt, kryesisht një apo disa minuta që konsistojnë shkarazi me zhanrin e tregimit; ato përmbajnë pamje arkivore, intervista, animacion dhe material tekstor për të eksploruar tema nga historia, kujtesa, politika dhe jeta njerëzore. Ky përdorim i formati të shkurtër, që bën Kluge mishëron angazhimin e tij për të eksperimentuar me formën, brenda së cilës trajton aspekte filozofike dhe sociale.	
{Sausages from Halberstadt} {Marrëveshjet e paqes janë aq të pabesa} {Ai se dëgjon fare!} {Sam remembers Papa Kong} {Trekëndëshi vdekjeprurës} {Banorët e Shangait buzë lumit Souzhou} {Gruaja në fushëbetejë} {Stuhi mbi Egjipt} {Lajmi i hidhur} {Çdo herë pas përmbysjes} {Shikoni ju lutem drejt në kamerë}	

Ligjërata, Panele, Diskutime

The war is back! "Abetarja e luftës 2023" e Alexander Kluges PANEL, E SHTUNË, 8.2.25, 17:00	kino armata
“Abetarja e luftës 2023” e Kluges është një eksplorim vizual dhe tekstual mbi luftën, historinë dhe përvojën njerëzore. I frymëzuar nga Abetarja e Luftës e Bertolt Brecht-it, Kluge ndërthur imazhe arkivash - fotografi konfliktesh – duke vendosur paralele përmes një përshkrimi poetik. Ai kritikon makinërinë e luftës, elasticitetin e jetës njerëzore dhe rrëfimet që vendosin historinë. Vepra kapërcen zhanret tradicionale, duke gërshtuar poezinë, materialin dokumentar dhe filozofinë për të reflektuar mbi ndikimin e dhunës dhe mënyrat se si e kujtojmë dhe interpretojmë luftën.	
Panelistë: Rainer Stollmann (Universiteti i Bremenit), Daniel Gönitzer (Universiteti i Vjenës), Alban Beqiraj (Përkthyes i "Abetarja e Luftës 2023")	Moderon: Dr. Blertë Ismajli (Universiteti i Prishtinës)
Sferat publike dhe kontra-publike pas krizave: Bisedë mes Alexander Kluges & Rainer Stollmann	LIGJËRATË & BASHKËBISEDIM, E ENJTE, 6.2.25, 17:15
Ligjërata e Prof. Dr. Rainer Stollmann fokusohet në kritikën e Alexander Kluges ndaj diskursit publik zyrtar dhe avokimit për forma alternative të ndërveprimit, duke lidhur inovacionin mediatik me krizat shoqërore. Ai shtjellon qasjen jokomerciale të Kluges mbi gërshetimin e mediave klasike dhe moderne, duke reflektuar angazhimin e tij për demokratizimin e hapësirave publike. Biseda ofron gjithashtu njohuri biografike mbi përvojat e autorit përgjatë kohës së luftës dhe thellohet në idetë teorike, duke përdorur materiale kyçe për të eksploruar temat e subjektivitetit, historisë dhe marrëdhënies midis realitetit dhe fiksionit. Alexander Kluge do të kyçet online në ligjëratë dhe do të bashkëbisedojë me Rainer Stollmann.	Moderon: Alexander Vojvoda

"Making an effort alone is of no use". Mbi "Artistët nën çatinë e cirkut: të përhumbur" dhe "Patriotja" LIGJËRATË & BISEDË, E PREMTE, 7.2.25, 18:30	
"Leni Peikert thotë: 'Dua të ndryshoj cirkun sepse e dua.' Veçse ajo e do, nuk do thotë ta ndryshojë atë. Ngase dashuria është konservative. Prandaj, Leni Peikert: 'Kjo nuk qëndron'”	
Në filmin “Patriotja” (Die Patriotin), Alexander Kluge shtjellon mënyrat se si historia mund të vihet në dyshim dhe të rimendohet përmes shembullit kërkimor mbi identitetin historik gjerman të Gabi Teichert. Në „Artistët nën çatinë e cirkut: të përhumbur“ (Die Artisten in der Zirkuskuppel: Ratlos), përpjekjet e Leni Peickert për të rishpikur cirkun simbolizojnë transformimin shoqëror përmes artit. Rrëfimet e fragmentuara të Kluges i vënë theks të veçantë rrjedhshmërisë së historisë dhe inkurajojnë angazhimin kritik. Në këtë ligjëratë, Blerta Hoçia, një artiste dhe kuratore e pavarur, e specializuar në fotografi, video dhe arkiva, do të reflektojë mbi qasjen e Kluges ndaj historisë si mjet për ndryshim shoqëror, kryesisht duke u bazuar në angazhimin e saj në aktivizmin kulturor në Kosovë dhe Shqipëri.	Moderon: Verena Walzl

Workshops

„Kopshte ndërtoj, rrënojave i besoj.” Alexander Kluge në kontekst Punëtori me Prof. Dr. Rainer Stollmann (Universiteti i Bremenit)	hani i dy robertëve
Punëtor ia do të thellohet në shtjellimet e Alexander Kluge mbi sferën publike dhe përvojën përmes leximeve ndërdisiplinare dhe diskutimeve. Pjesëmarrësit do të ndërveprojnë me tekste të përzgjedhura, duke përfshirë shkrimet e Kluges, fragmente nga “Dialektika e Iluminizmit” (Adorno/Horkheimer) dhe “Transformimi i ri i sferës publike dhe politika deliberative” (Habermas). Përmes studimit të përbashkët dhe dialogut, punëtor ia synon të shpalosë tematikat kyçe të Kluges mbi ndërtimin e “kopshteve” (hapësirat për reflektim dhe rritje) në mes të “rrënojave” të modernitetit, duke ofruar njohuri mbi qasjen e tij unike ndaj diskursit publik, historisë dhe kreativitetit.	E SHTUNË, 8.2.25, 10:00
Prof. Dr. Rainer Stollmann është profesor universitar i pensionuar i Teorisë Kulturore dhe Historisë Kulturore në Universitetin e Bremenit. Pas studimeve për filologji dhe histori, ai ka doktoruar mbi letërsinë dhe fashizmin. Më pas ka bashkëthemeluar programin e Studimeve Kulturore në Bremen në vitin 1986. Në vitin 1995, Stollmann përfundoi habilitimin e tij më temën “Natyra dhe kultura e të qeshurit”.	
Rreziku i “të mbeturit të butë.” Kritika feministe e Alexander Kluge mbi blindimin Punëtori me Daniel Gönitzer BA MA (Universiteti i Vjenës)	E PREMTE, 7.2.25, 10:00
Sipas Alexander Kluges, nuk ka alegori më të mirë që shpjegon parimin thelbësor të Iluminizmit sesa imazhi i kërmillit të ndjeshëm nga Dialektika e Iluminizmit (Adorno/Horkheimer). Krahas përsiatjes së tij të hershme e të vazhdueshme mbi butësinë, ndjeshmërinë dhe kuriozitetin, puna e tij më e re (sikurse Kriegs fibel [Abetarja e Luftës]) gjithnjë e më shumë përfshin refleksione mbi fortësinë, mburojën dhe koracimin. Në këtë punëtor ie, do të trajtojmë perspektivat feministe në apelin e Kluges për butësinë dhe kritikën pasuese ndaj koracimit. Përveç veprave të Kluges, do të diskutohen edhe pasazhe nga Eva von Redecker, Klaus Theweleit dhe Theodor W. Adorno. Daniel Gönitzer është asistent universitar në tfm Departamenti i teatrit, filmit dhe studimeve mediatike në Universitetin e Vjenës. Ai ka përfunduar studimet për filozofi dhe letërsi gjermane në Grac dhe Vjenë. Doktoratura e tij trajton lidhjen e Walter Benjami nit me avantgardën historike.	



Pas luftërave botërore, tash u lodha së stërvituri kafshë sa për spektakël

Mësymja e së tashmes ndaj
kohës së ngelur

ALEXANDER KLUGE:
NJË RETROSPEKTIVË

6.2. - 8.2.25

kino armata
Brigada e Kosovës
10 000 Prishtina
Kosovo

hani i dy robertëve
Hajdar Dushi 62
10 000 Prishtina
Kosovo

info:

mail@stralli.org

Instagram: Stralli_org

Facebook: Stralli

financuar nga / financed by

GOETHE-ZENTRUM
KOOPERATIONSPARTNER



partnerë / partners

ARMATA



Deutscher Akademischer Austauschdienst
German Academic Exchange Service

Hani i 2 Robertëve

organizuar nga / organized by

STRALLI